

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

### MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L62102007V

NUIS/NIPT

Gurten sh.p.k, Rruga e Kavajes , Nr 116

Adresa

Tiranë

Albania

1001

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0684030522

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

ernolda\_yzeiraj@yahoo.com

E-mail

Administrator Safet Hoxhalli

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/10/27

Data (viti/muaji/dita)

0684030522

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-84407-10-19-2023

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Bashkia Korce

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

8323000

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të MZSH

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2023/10/30

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Mallra

2023/10/30

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

REF-84407-10-19-2023

35110000-8

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Autoriteti kontraktor Bashkia Korçe më datë 20.10.2023, ka publikuar në sistemin elektronik të APP-së procedurën “E hapur, e thjeshtuar”. “Shpenzime për blerje pajisje profesionale që ju shërbejnë strukturave të MZSH” me fond limit 8 323 000 (Tete milion e treqind e njetete e tre mijë) lekë pa tvsh me Nr. REF-84407-10-19-2023.

Nga verifikimi i specifikimeve teknike na rezulton se ka paqartesi të medha duke krijuar konfuzion tek operatorët ekonomikë të cilët do të marrin pjesë në procedurën e lartpërmendur.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Referuar dhe kërkeses për sqarim të bërë nga një operator tjetër ekonomik në sistem si dhe përgjigjes së autoritetit kontraktor duke mos dhënë asnjë arsye apo sqarim lidhur me pikat e ngritura prej tij, ju drejtohem me ankese pasi kërkesa për sqarimin e specifikimeve teknike është e domosdoshme dhe për shoqëritë tona.

Specifikime të tilla duke bërë një përshkrim të përgjithshëm dhe pa cilesuar asgjë konkrete i vendos operatorët ekonomikë në kushte ku komisioni i marrjes në dorezim të pajisjeve bën një interpretim sipas interesave personale duke shkaktuar dem tek operatorët ekonomikë.

Me poshtë po ju parashtrojmë konstatimet e shoqërisë sonë të cilat janë të njëjta me operatorin tjetër ekonomik që ka bërë kërkesë për sqarim në sistem.

1. Autoriteti Kontraktor për zërin “Shkallë profesionale zjarrfikëse me 3 elemente” përcakton “Shkallët janë projektuar duke përdorur teknologjinë dhe materialet më të fundit për të përmbushur nevojat specifike të departamenteve të zjarrfikësve dhe shpëtimit”

Nuk kuptohet çfarë ka dashur të thotë autoriteti kontraktor me “?tekonologjinë dhe materialin e fundit”, pasi kushdo nga antaret apo me saktë kryetari i komisionit të marrjes në dorezim nuk është dakort me cilesimin tonë mbi teknologjinë dhe materialin e cilesuar prej nesh si “material i fundit”

2. Autoriteti Kontraktor për zërin “Shkallë profesionale zjarrfikëse me 3 elemente” përcakton “I përshtatshëm për një ngarkesë maksimale prej 3 personash”

Nuk kuptohet çfarë ka dashur të thotë autoriteti kontraktor me ngarkesë maksimale prej 3 personash pasi numri i personave nuk është njësi matëse.

3. Autoriteti kontraktor përcakton që shkallët të jenë në përputhje me standartin EN 1147 ose ekuivalent (DIN,O-Norm, BS), ndërkohë që cilesimet e tjera nuk kanë lidhje me këtë standard.

4. Sa i përket zërit Aparat AP3 citojmë dhe njëherë operatorin tjetër ekonomik në kërkesën për sqarim dhe kërkojmë përgjigje dhe saktësim konkret ndryshe nga argumentimi i autoritetit kontraktor. Është bërë një përshkrim 5 faqe A4 për aparatën AP3 frymemarrje për mënyrën e funksionimit të tyre të cilat me shumë sjellin konfuzion tek OE: “...një diafragmë e të folurit është montuar brenda maskës së brendshme me një dalje direkte jashtë maskës, maska është në versionin me një hapësirë ajri të ambientit..., kompjuteri i aparatit të frymemarrjes..., njësi e ekranit dixhital, sistemi universal i lidhjes ajrore të ekuipazhit etj. Nderkohe që nuk na është dhënë një certifikim për këtë produkt, pasi çdo produkt certifikohet sipas standardeve përkatëse. Theksojmë se çdo përshkrim i tillë mbetet në vlerësimin e antareve të komisionit apo me saktë të kryetarit të komisionit të marrjes në dorezim mbi interpretimin e tyre, duke shkaktuar dem ekonomik tek

operatorët të cilët lidhin kontratën me AK.

5. Lidhur me zerin Maske e plote e fytës, sasia 16 cope, siç është përcaktuar dhe prej AK është pjesë e aparatit të frymëmarrjes AP3. Nderkohe që janë kërkuar 16 cope dhe 5 cope AP3. Cdo pajisje AP3 ka pjesë të tilla dhe maskën, pra sasia e maskave që keni kërkuar përfshin edhe maskat e AP3. A janë 11 maska apo 11+5 maska të AP3? Njësori si tek të gjitha specifikimet e zerave keni vendosur përshkrime të maskës dhe jo certifikimin e saj.

6. Për zerin Litar shpëtimi rezistent ndaj zjarrit, autoriteti kontraktor përcakton "Litari është në gjendje të rezistojë zjarrit të hapur afatshkurtër dhe në kushte të rrezatueshme me një temperaturë deri në 400 °C". Nderkohe që ky specifikim nuk është i saktë pasi në 400°C, jo litar që nuk i reziston por edhe material tjetër.

7. Për zerin "Motosharre", AK ka përcaktuar që të respektoje standardet aktuale të cilësimit të ajrit, CE. Nderkohe që dëkja e tilla nuk ekziston. AK kërkon që pajisja të jetë e shoqëruar me aksesoret e nevojshme për përdorim normal të saj. Çka le në dorë të komisionit apo me saktë të kryetarit të komisionit të marrjes në dorëzim se çfarë është e nevojshme dhe çfarë jo duke shkaktuar dëm ekonomik tek operatori i cili do të lidhi kontratën.

8. Për zerin "jelek shpëtimi", AK në specifikimet teknike e cileson si pajisje lundruese personale e krijuar për reaguesit e shpejtë të ujit. Nderkohe që nuk është dhënë asnjë foto ilustruese e këtij produkti apo se ku dhe për çfarë do të përdoret.

9. Përsa i përket zerit "Pompe zhytëse në 2 modele" specifikimet nuk përputhen dhe është totalisht e paqarte se çfarë pompe kërkohet konkretisht.

10. Përsa zerave "Cilinder hidraulik" dhe "Cilinder hidraulik me profil të ulët" kanë mangësi të theksuara lidhur me funksionimin e këtyre cilindrave nëse janë me përdorim manual, me bateri, me gjenerator hidraulik apo tjetër.

Gjithashtu për të gjitha zerat keni përcaktuar se pesha dhe përmasat janë relative në varesi të prodhuesit nderkohe që në specifikime janë dhënë pesha dhe përmasa konkrete, çka bie ndesh me përcaktimin tuaj.

Sa më sipër kërkojmë:

1. Korigjimin e specifikimeve teknike, në mënyrë që ajo çka do të ofrojë operatorët ekonomikë të jetë sa më e qartë dhe për të mos lënë vend për vlerësim relativ nga ana e komisionit apo me saktë të kryetarit të komisionit të marrjes në dorëzim të produkteve. Nëse AK e ka të paqartë se çfarë kërkon të prokurorja me anë të specifikimeve teknike mund të orjentojë operatorët ekonomikë nëpërmjet fotove përkatëse.

2. Kërkojmë të shqyrtohet se ku është bërë studimi i tregut, pasi në Shqipëri duke qenë se objekti i prokurimit është i lidhur ngushtë me një numër të vogël subjektësh që kanë këtë lloj veprimtarie nuk është marrë asnjë ofertë nga ana e tyre. Në bazë të LPP studimi i tregut bëhet nga shoqëri që kanë lidhje me objektin e prokurimit në Shqipëri dhe jo në shoqëri Afrikane siç na është përcjellë nga ana e AK. Kërkojmë të shqyrtohet me seriozitet se çfarë janë këto produkte, çfarë çmimesh kanë, kush firma i kanë ofruar dhe çfarë lidhje kanë këto firma që kanë firmosur ofertat për studimin e tregut me objektin e prokurimit.

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

## 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

Jo

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

Jo

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

ernolda\_yzeiraj@yahoo.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Safet Hoxhalli